

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2022*

15.04.2022
Ora 12:27

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shpalljen e rezultatit të përzgjedhjes rastësore të qendrave të votimit që do t’i nënshtrohen këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe të materialeve zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y. Merkaaj, E. Meta, P. Shaho**
- **Parti Politike:**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Duke ju kërkuar ndjesë për fillimin e kësaj seance, ju bëj me dije se ka vetëm një pikë në rendin e ditës dhe ajo ka të bëjë me hedhjen e shortit për përzgjedhjen e qendrave të votimit të cilat do t’i nënshtrohen procesit të verifikimit paszgjedhor. Pra, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars të këtij viti. Atëherë sikurse kemi proceduar edhe në rastin e përzgjedhjes së qendrave të votimit për verifikimin paszgjedhor të zgjedhjeve të 25 Prillit 2021, të njejtën procedurë do të ndjekim. Gjithësesi për njohje nga të gjithë mund të bëjë një prezantim të shkurtër sekretari, ose drejtori në lidhje me procedurën që do të ndiqet, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2022*

Z. Y. Merkaj: Neni 167/2, i Kodit Zgjedhor përcakton se këqyrja e mëpasshme e fletëve të votimit, e materialit zgjedhor bëhet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me përzgjedhje rastësore ose me kërkesë të palëve të interesuara me përcaktim. Këqyrja kryesisht si rregull shtrihet jo më shumë se 10% e qendrave të votimit. Procesi i këqyrjes paszgjedhore konsiston në hapjen e kutive të votimit dhe të kutive të materialeve zgjedhore si dhe monitorimin dhe vlerësimin e funksionimit të paisjeve të teknologjisë dhe informacionit të përdorura në zgjedhje. Qëllimi i këtij procesi është të verifikojë rregullshmërinë dhe saktësinë e veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave. Me vendimin nr. 143 datë 13 prill 2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është miratuar procedura e këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Procedura e përcaktimit rastësor të qendrave të votimit është si më poshtë:

1. Qendrat e votimit të numërtuara sipas sistemit unik të numërimit renditen nga numri më i vogël tek më i madhi, përfshirë fraksionet e nënrenditura menjëherë pas QV mëmë, në rang KZAZ-je, në një skedar excel të eksportuar nga sistemi i QV-ve të KQZ-së. Në këtë skedar janë përjashtuar nga renditja QV-të e KZAZ nr. 26 ku është bërë votimi elektronik si dhe qendrat e votimit nr. 0092, nr. 0132, nr. 0133, të KZAZ nr. 2, Bashkia Shkodër, në të cilat nuk u zhvilluan zgjedhje në datën 6 Mars 2022.
2. Skedari elektronik përmban minimalisht të dhëna për qarkun, bashkinë, ZAZ-në, njësinë Administrative, numrin e QV-ve sipas SUN, vendndodhjen e qv-së, si dhe numrin rastësor. Në kolonën numër rastësor, për çdo qelizë vendoset formula e gjenerimit të një numri rastësor me presje dhjetore për çdo QV, nga 0 – 1. Ky numër

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2022**

rastësor është i ndryshueshëm sa herë që bëhet filtrimi, editimi apo rirenditja e QV-ve.

3. I gjithë procesi do të shfaqet në ekranin që ndodhet në sallën e mbledhjeve. Në tabelën Excel do të filtrohen nga tërësia e QV-ve, Zonën e Administrimit Zgjedhor dhe në kolonën “numri rastësor”, i rendit numrat rastësor nga më i vogli tek më i madhi.

Numri maksimal i QV-ve që do t’i nënshtrohet procesit të këqyrjes për zgjedhjet për kryetar bashkie të datës 6 mars është si më poshtë:

Për ZAZ-në nr. 2 do të jenë 11 qendra votimi që do të verifikohen;

Për ZAZ-në nr. 3 do të jenë 5 qendra votimi;

Për ZAZ-në nr. 4 do të jenë 5 qendra votimi;

Për ZAZ-në nr. 5 do të jenë 5 qendra votimi;

Për ZAZ-në nr. 19 do të jenë 10 qendra votimi;

Për ZAZ-në nr. 21 do të jenë 11 qendra votimi;

Për ZAZ-në nr. 22 do të jenë 8 qendra votimi;

Për ZAZ-në nr. 23 do të jenë 8 qendra votimi;

Për ZAZ-në nr. 24 do të jenë 7 qendra votimi;

Për ZAZ-në nr. 43 do të jenë 5 qendra votimi;

Për ZAZ-në nr. 54 do të jenë 9 qendra votimi;

Për ZAZ-në nr. 55 do të jenë 6 qendra votimi.

Numrat e renditur të parët për secilën ZAZ do të jenë QV-të të cilat do t’i nënshtrohen verifikimit.

4. Ky rregull do të zbatohet për çdo ZAZ sipas rendit rritës deri në përfundimin e të gjitha ZAZ-ve. Në përfundim të procesit të përzgjedhjes rastësore do të merret edhe vendimi nga Komisioneri për miratimin e rezultateve të përzgjedhjes rastësore të

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2022**

qendrave të votimit që do t'i nënshtrohen këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore të datës 6 Mars 2022, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Procedura do të zhvillohet nëpërmjet aplikacionit elektronik dhe përzgjedhja bëhet nëpërmjet procesimit të të dhënave nga ky aplikacion. E kemi gati?

Z. E. Meta: Po! Referuar dhe vendimit do të fillojmë përzgjedhjen sipas çdo ZAZ-je. Fillojmë me ZAZ-në nr. 2. Në këtë ZAZ do të përzgjedhim 11 qendra votimi të renditura të parat nga numëri rastësor.

Z. P. Shaho: ZAZ nr. 2, Bashkia Shkodër janë përzgjedhur:
QV-0110, QV-0117, QV-0327, QV-0098, QV-0206, QV-0077, QV-0225, QV-0102/1, QV-0097, QV-0108, QV-0103;


Z. I. Celibashi: Kalojmë te KZAZ-ja nr. 3!

Z. E. Meta: KZAZ nr. 3, Bashkia Shkodër do të përzgjidhen 5 qendra votimi.

Z. P. Shaho: Për ZAZ-në nr. 3, Bashkia Shkodër janë përzgjedhur: QV-0289, QV-0245/1, QV-0292, QV-0303, QV-0293.

Z. E. Meta: Viojmë me KZAZ-në nr. 4, edhe në këtë KZAZ numri i qendrave të votimit të cilat do të përzgjidhen janë 5.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2022*

Z. P. Shaho: Për ZAZ-në nr. 4, Bashkia Shkodër, janë përzgjedhur qendrat e votimit:
QV-0319, QV-0263/1, QV-0265, QV-0261, QV-0316/2.

Kalojmë te ZAZ-ja nr. 5, Bashkia Shkodër janë përzgjedhur 5 qendra votimi:
QV-0320, QV-0307/1, QV-0309/1, QV-0314/1 dhe QV-0323/1.

Kalojmë te ZAZ-ja nr. 19, Bashkia Dibër, janë përzgjedhur 10 qendra votimi:
QV-1149, QV-1174, QV-1096, QV-1163, QV-1134, QV-1173, QV-1226, QV-
1166, QV-1189 dhe QV-1186.


Kalojmë te ZAZ-ja nr. 21, Bashkia Durrës, janë përzgjedhur 11 qendra votimi:
QV-1354/1, QV-1328, QV-1384/1, QV-1355, QV-1363, QV-1356/1, QV-1374,
QV-1348, QV-1520, QV-1345, QV-1514.

Kalojmë te ZAZ-ja nr. 22, Bashkia Durrës, janë përzgjedhur 8 qendra votimi:
QV-1467/1, QV-1470, QV-1419/1, QV-1410/1, QV-1414/1, QV-1467/2, QV-1417,
QV-1469/2.

Kalojmë te ZAZ-ja nr. 23, Bashkia Durrës, janë përzgjedhur 8 qendra votimi:
QV-1433/1, QV-1461/1, QV-1448, QV-1461, QV-1447/1, QV-1501, QV-1480,
QV-1443/1.

Kalojmë te ZAZ-ja nr. 24, Bashkia Durrës, janë përzgjedhur 7 qendra votimi:
QV-1437/1, QV-1438, QV-1465, QV-1435, QV-1496, QV-1497/1, QV-1425/1.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2022*

Kalojmë te ZAZ-ja nr. 43, Bashkia Rrogozhinë, janë përzgjedhur 5 qendra votimi:
QV-2227/1, QV-2148/1, QV-2148, QV-2154 dhe QV-2197.

Kalojmë te ZAZ-ja nr. 54, Bashkia Lushnje, Qarku Fier do të përzgjedhim 9
qendra votimi: QV-2827, QV-2918, QV-2964, QV-2973, QV-2838, QV-2905,
QV-2815, QV-2833, QV-2902.

Kalojmë te ZAZ-ja nr. 55, Bashkia Lushnje, do të përzgjedhim 6 qendra votimi:
QV-2874/1, QV-2880/1, QV-2866, QV-2879, QV-2857, QV-2869/1.
Me ZAZ-në nr. 55 e mbyllim shortin elektronik.

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit, atëherë seanca mbyllet do të njoftojmë për
zhvillimin e procesit të verifikimit paszgjedhor në ditët në vijim, faleminderit!

Vendimi nr. 145

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

